



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr. 97/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “G...” Sh.p.k., me seli në Prishtinë, Pallati i Rinisë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Bajram Morina, me seli në Gjakovë, kundër të paditurit Njësia për Inteligjencë Financiare, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të vendimit FIUAD 51/2019 të datës 13.03.2019, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 07.11.2022, në prezencë përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, me datë 14.11.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadija e paditësit “G...” Sh.p.k., me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit FIUAD 51/2019 të datës 13.03.2019 i nxjerrë nga i padituri Njësia për Inteligjencë Financiare.

A r s y e t i m

Paditësi “G...” Sh.p.k., ka parashtruar padi me kërkesë për anulimin e vendimit FIUAD 51/2019 të datës 13.03.2019 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në kuadër të paditurit Njësia për Inteligjencë Financiare (NjIF) dhe vendimit FIUAD 21/2019 të datës 25.01.2019, si të kundërligjshëm, me arsyetimin se nuk qëndron arsyetimi i të paditurit se z. I.V si pronarë i paditësit ka qenë i ftuar nga i padituri në trajnimin për kazinot dhe objektet e licencuara për lojëra të fatit, andaj duke qenë në mungesë të informacionit për detyrimet e tij, me datë 15.02.2019 ka kërkuar nga i padituri asistencë – këshilla profesionale lidhur me zbatimin në praktikë të Ligjit nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (më tutje referuar edhe si Ligji nr. 05/L-096). Gjithashtu ka theksuar se i padituri gjatë shqyrtimit të ankesës ka anashkaluar faktin se paditësi brenda afatit prej 15 ditëve i lejuar nga i padituri ka përpiluar dhe aprovuar Rregulloren për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit si dhe ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pajtueshmëri dhe se i padituri nuk ka dhënë ndonjë vërejtje ndaj këtyre akteve të nxjerra

nga paditësi. Po ashtu ka shtuar se nuk është kompetencë e të paditurit të kujdeset për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi që me këtë ligj është krijuar Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si agjension i pavarur përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale. Në seancën e shqyrtimit kryesor ka qëndruar në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke shtuar se në bazë të neneve 24, 26, 42 dhe 52 të Ligjit për Lojërat e Fatit janë paraparë rregullat për ushtrimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes së subjekteve që ushtrojnë lojërat e fatit dhe Administrata Tatimore e Kosovës është autoritet i vetëm mbikëqyrës i lojërave të fatit funksion të cilin gjithmonë e ka ushtruar, andaj gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit ashtu që të anulohet vendimi FIUAD 51/2019 i datës 13.03.2019 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në kuadër të paditurit Njësia për Inteligjencë Financiare (NJIF).

I padituri me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit duke theksuar se i padituri në përputhje me nenin 35 të Ligjit nr. 05/L-096 nga data 09.10.2018 deri me datë 12.10.2018 ka realizuar inspektimin në vend tek paditësi i cili është subjekt raportues bazuar në nenin 16 par. 1.3 të Ligjit nr. 05/L-096 për çfarë paditësit është njoftuar paraprakisht me datë 15.10.2018. Ka shtuar se gjatë këtij inspektimi, i padituri ka mbajtur procesverbal në të cilin ka konstatuar se paditësi ka dështuar në implementimin e nenit 21 të Ligjit nr. 05/L-096 për emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë, ka dështuar në identifikimin e klientëve sipas nenit 19, ka dështuar në procedurën për raportim në NJIF sipas nenit 26, mos posedimi i listës së indikatorëve, mos vijueshmëria në trajnim të brendshëm apo të jashtëm nga të punësuarit e paditësit, dështimi në aspektin e përcaktimit të rrezikut në mënyrë periodike sipas nenit 18, andaj duke u bazuar në këto gjetje, sektori për pajtueshmëri dhe inspektim në NJIF ka shqiptuar ndëshkim administrativ në vlerë prej 25,000€ për shkeljet e evidentuara në nenin 43 par. 1.1, 1.2, 1.7, 1.9, 1.13, 1.16 dhe 1.18 të Ligjit nr. 05/L-096. Lidhur me pretendimet e paditësit në padi ka theksuar se është pikërisht pronari i paditësit i cili ka qenë i ftuar në trajnim nga paditësi trajnim i cili është mbajtur me datë 29.04.2014, ndërsa lidhur me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP) ka theksuar se në bazë të nenit 3 par.3, nenit 4 par.5 të LMDhP lidhur me nenin 20 par.1 të Ligjit nr. 05/L-096, përcaktohet obligimet edhe me ligj tjetër përkatës ashtu siç është rasti në këtë çështje. Krejt në fund ka theksuar se i padituri gjatë shqyrtimit të ankesës ka vlerësuar edhe sqarimin e paditësit të datës 09.01.2019, por ka vlerësuar se paditësi nuk ka mundur të arsyetoj të gjitha gjetjet e evidentuara gjatë inspektimit andaj gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit si e pabazuar, ndërsa vendimi i kontestuar të mbetet fuqi. Në seancën e shqyrtimit kryesorë nuk ka prezantuar

edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, andaj gjykata shqyrtimin kryesor të çështjes e ka mbajtur në mungesë të palës së paditur në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendim FIUAD 51/19 i datës 13.03.2019; kërkesë për dhënien e udhëzimeve nr. 42/19 e datës 15.02.2019; ankesë kundër vendimit nr. 21/19 e datës 25.01.2019; informatë nr.05/2019 e datës 11.01.2019; rregullore për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit; vendim mbi emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë i datës 26.10.2018; vendim nr. FIUAD 21/19 i datës 25.01.2019; faturë për pagesën e ndëshkimit administrativ e lëshuar nga NJIF 25.01.2019; inspektimi i pajtueshmërisë në vend nga NJIF i datës 05.10.2018; procesverbal i inspektimit të pajtueshmërisë për subjektin G... Sh.p.k në 7 faqe; kërkesë për sqarim nr. 252/18 e datës 28.12.2018; email i datës 25.04.2014 drejtuar paditësit.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 41 dhe 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurës si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Gjykata konstatoi se me Vendimin FIUAD 21/2019 të datës 25.01.2019 i nxjerrë nga Njësia për Inteligjencë Financiare, subjektit raportues N.T.Sh. "G..." i është shqiptuar ndëshkimi administrativ në vlerë prej 25,000€ (njëzet e pesëmijë euro) sipas nenit 44 par.1.2 për shkeljet administrative të përcaktuara në nenin 43 par. 1.1, 1.2, 1.7, 1.9, 1.13, 1.16 dhe 1.18 të Ligjit nr. 05/L-096.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin, ka ushtruar ankesë me datë 15.02.2019, të cilën i padituri me Vendimin FIUAD 51/2019 të datës 13.03.2019 e refuzuar si të pabazuar dhe ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë FIUAD 21/2019 të datës 25.01.2019.

Paditësi i pakënaqur me këtë vendim, ka ushtruar padi në gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 52 par. 1 të Ligjit nr. 05/L-096 i cili përcakton se: *"1. Shqiptimi i ndëshkimit administrative nga NJIF-K, BQK dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial mund të ankimohet në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë, tridhjetë (30) ditë nga data e dërgimit të vendimit final për ndëshkim administrativ."* si dhe në kuptim të nenit 13 par.1 të Ligjit për

Konfliktet Administrative i cili përcakton se: *“1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë.”*

Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga i padituri në procedurë administrative dhe në kundërshtim me provat e administruara.

Nga prova inspektimi i pajtueshmërisë në vend nga NJIF i datës 05.10.2018, gjykata ka konstatuar se i padituri ka njoftuar paditësin se nga data 09.10.2018 deri me 12.10.2018 duke filluar nga ora 10:00 do të kryej inspektim të pajtueshmërisë në ambientet e punës së subjektit N.T.SH. “G...” si subjekt raportues i përcaktuar në nenin 16 par.1.3 të Ligjit nr. 05/L-096, të cilin njoftim e ka pranuar I.Vme datë 05.10.2018.

Nga prova procesverbal i inspektimit të pajtueshmërisë për subjektin G... Sh.p.k., gjykata ka konstatuar se i padituri në prezencën e personit të autorizuar të paditurit z. B.V ka kryer inspektimin në njësinë e paditësit në rr. dhe ndër të tjera kanë konstatuar se nuk është caktuar zyrtari për pajtueshmëri, nuk bëhet identifikimi i klientëve në hyrje, në rast se fitojnë apo në rast se janë persona të ekspozuar politikisht si dhe nuk posedojnë listë të personave të ekspozuar politikisht. Po ashtu është konstatuar se deri në ditën e inspektimit nuk është raportuar në NJIF, nuk kanë listë të indikatorëve dhe nuk posedojnë rregullore të brendshme për vlerësimin dhe parandalimin e rrezikut. Gjykata po ashtu ka konstatuar se ky procesverbal është nënshkruar nga zyrtarët e NJIF dhe përfaqësuesi i paditësit.

Nga prova faturë për pagesën e ndëshkimit administrativ e lëshuar nga NJIF me datë 25.01.2019, gjykata ka konstatuar se i padituri së bashku me vendimin FIUAD 21/2019 të datës 25.01.2019 paditësit i ka lëshuar edhe faturën për pagesën e gjobës administrative.

Nga prova kërkesë për sqarim nr. 252/18 e datës 28.12.2018, gjykata ka konstatuar se i padituri pas inspektimit të kryer, e ka njoftuar paditësin me gjetet e bëra në inspektim si dhe i ka dhënë mundësinë që në afat prej 2 jave të dozojë me shkrim observimet e paditësit lidhur me çështjet e konstatuar gjatë inspektimit.

Nga prova informatë nr. 05/2019 e datës 11.01.2019, gjykata ka konstatuar se paditësi ka njoftuar të paditurin se e kanë kuptuar se i nënshtrohen Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit vetëm pas vizitës inspektuese të realizuar me datë 09.10.2018 dhe se janë të gatshëm për bashkëpunim dhe se me datë 25.10.2018 kanë miratuar aktin normativ respektivisht rregulloren për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e terrorizmit si dhe kanë nxjerrë vendimin mbi emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë

me numër prot. 87/18 të datës 26.10.2018 dhe se i njëjti është në pritje të NJIF që sa më parë të vëjë raporte punuese në rrugë zyrtare.

Nga prova rregullore për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, gjykata ka konstatuar se paditësi me datë 25.10.2018 ka miratuar rregulloren e lartcekur në përputhje me nenin 16 par.1, pika 1.3 dhe nenin 17 par.2 të Ligjit nr. 05/L-096.

Nga prova vendim mbi emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë i datës 26.10.2018, gjykata ka konstatuar se paditësi përmes këtij vendimi ka emëruar B.V si zyrtarë i pajtueshmërisë.

Nga prova kërkesë për dhënien e udhëzimeve nr. 42/19 e datës 15.02.2019, gjykata ka konstatuar se paditësi i është drejtuar të paditurit me kërkesë për udhëzime – këshilla profesionale lidhur me zbatimin në praktikë të Ligjit nr. 05/L-096.

Nga prova email i datës 25.04.2014 drejtuar paditësit, gjykata ka konstatuar se i padituri përmes email ka ftuar v. V. në trajnimin për kazinotë dhe objektet e licencuara të lojërave të fatit.

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur paditësit i ka shqiptuar gjobë në shumë prej 25,000€ për shkak të shkeljes së dispozitave të Ligjit nr. 05/L-096 e të cilat janë të sanksionuara me nenin 43 par.1, nën-par. 1.1, 1.2, 1.7, 1.9, 1.13, 1.16 dhe 1.18 të këtij ligji.

Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur, gjykata iu referua nenin 16 par.1, nën-par. 1.3 të Ligjit nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit i cili përcakton se: *“1. Subjekte raportuese për qëllime të këtij ligji janë: ... 1.3. kazinotë, përfshirë ato në internet dhe objektet e licencuara të lojërave të fatit; ...”* si dhe nenin 43 par. 1, nën-par. 1.1, 1.2, 1.7, 1.9, 1.13, 1.16 dhe 1.18 të njëjtit ligj, të cilat përcaktojnë se: *“1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji si në vijim paraqesin shkelje të rënda: 1.1. dështimi në përputhje me detyrimin që të nxirren politika dhe procedura të brendshme të shkruara në vendosjen kontrolleve për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe në zbatimin e tyre siç përcaktohet në nenin 17 të këtij ligji; 1.2. mospërmbushja e obligimeve formale të identifikimit, siç përcaktohet në nenin 19 të këtij ligji; ... 1.7. mospërmbushja e detyrimit të aplikimit të masave të kujdesit të duhur të shtuar, siç përcaktohet në nenin 22 të këtij ligji; ... 1.9. dështimi në përputhje me detyrimin e vlerësimit të rrezikut, siç përcaktohet në nenin 18 të këtij ligji; ... 1.13. mosrespektimi i detyrimit për mbajtjen e të dhënave, siç përcaktohet në nenin 20 të këtij ligji; ... 1.16. dështimi në përputhje me detyrimin e njoftimit të NjIF-K për emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë të subjektit raportues ose zëvendësit të tij, ose refuzimit për të adresuar kundërshtimet ose vërejtjet e bëra sipas kushteve*

të nenit 21 të këtij ligji; ... 1.18. dështimi në përputhje me detyrimin e trajnimit të punonjësve, sipas nën-paragrafit 2.5. të nenit 17 të këtij ligji;” Gjithashtu në nenin 44 par.1, nën-par. 1.2, pika 1.2.1 të këtij ligji përcaktohet se: “1. Për shkelje të rënda të përcaktuara në nenin 43 të këtij ligji, NJIF-K, BQK, si dhe mbikëqyrësit e tjerë sektorial nëse kjo kompetencë i është dhënë sipas paragrafit 5. të nenit 34 të këtij ligji, mund të shqiptojë ndëshkim administrativ siç definohet në vijim, përveç nëse është parashikuar një ndëshkim më i rëndë sipas nenit 41 të këtij ligji: ... 1.2. gjobë: ... 1.2.2. një shumë maksimale që mund të vendoset deri në pesë përqind (5%) të vlerës neto të subjektit raportues sipas llogarive më të fundit në dispozicion të aprovuara nga bordi menaxhues, por jo më pak se njëzetmijë (20.000) euro;”

Në kuptim të dispozitave të lartcekura, gjykata vlerësoi pretendimet e përfaqësuesit të paditësit se Administrata Tatimore e Kosovës është autoriteti i vetëm mbikëqyrës i lojërave të fatit dhe se i padituri nuk ka pasur ndonjë autoritet mbikëqyrje në këtë rast, por gjykata vlerëson se nga neni 16 par. 1, nën-par. 1.3 i Ligjit nr. 05/L-096, paditësi kualifikohet si *subjekt raportues*, ndërsa në nenet 17, 18, 19,20, 21 dhe 22 të këtij ligji janë përcaktuar detyrimet e *subjekteve raportuese* e që në këtë rast përfshihet edhe paditësi.

Ndërlidhur me nenin 43 dhe 44 të Ligjit nr. 05/L-096 që përcaktojnë sanksionet për shkeljen e dispozitave përkatëse të këtij ligjit, gjykata vlerëson se neni 17 i Ligjit nr. 05/L-096 përcakton obligimin e paditësit si subjekt raportues që të nxjerr rregullore dhe procedura të brendshme të shkruara, vendos kontrole për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe ti zbatoj ato lidhur me procedurat për: identifikimin dhe verifikimin e klientit; raportimin lidhur me të gjitha aktivitetet ose transaksionet e dyshimta dhe në vlerë 10,000€ (dhjetëmijë euro) ose më shumë sipas nenit 26, emërimin e zyrtarit të pajtueshmërisë, sigurimin e organizimit dhe financimit të programit për trajnimin dhe aftësimin e të punësuarve, përfshirjen e listës së indikatorëve të hartuar nga NJIF dhe plotësimin e asaj liste me indikatorë sipas fushëveprimit të subjektit raportues dhe procedurën për grumbullimin, mbajtjen, mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave në pajtim me këtë ligj dhe procedurën për parandalimin e qasjes së paautorizuar. Lidhur me këtë, nga prova procesverbal i inspektimit të pajtueshmërisë, gjykata vlerëson se paditësi nuk i ka përmbushur këto obligime, andaj konstatimi i të paditurit se paditësi ka shkelur nenin 42 par.1, nën-par. 1.1 dhe 1.18 të Ligjit nr. 05/L-096 është i drejtë. Gjukata vlerësoi edhe faktin se paditësi ka dorëzuar si provë rregullore për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe faktin se e njëjta është nxjerrë pas realizimit të vizitës inspektuese, por gjykata vlerëson se një rrethanë e tillë nuk ishte me ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore të paditësit deri në

kohën e realizimit të inspektimit nga ana e të paditurit, kjo pasi që detyrimin ka rrjedhur nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit.

Gjykata po ashtu konstatoi se me nenin 18 të Ligjit nr. 05/L-096 është përcaktuar obligimi i subjekteve raportues (përfshirë edhe paditësin) që të bëjnë vlerësimin e parandalimit të rrezikut, ndërsa nga prova procesverbal i inspektimit të pajtueshmërisë, gjykata vlerëson se paditësi nuk e ka përmbushur këtë obligim, andaj gjoha e shqiptuar nga i padituri duke u mbështetur në nenin 42 par.1, nën-par. 1.9 të Ligjit nr. 05/L-096 është e drejtë.

Gjykata i gjeti si të bazuara edhe konstatimet e të paditurit lidhur me shkeljet nga neni 19 i Ligjit nr. 05/L-096 pasi që sipas kësaj dispozite paditësit ka pasur për obligim që të bëjë identifikimin e klientit dhe verifikimin e identitetit të klientit, me anë të burimeve të pavarura, dokumenteve, të dhënave ose informacioneve të besueshme, ndërsa në procedurë administrative është vërtetuar se i njëjti nuk bënë identifikimin dhe verifikimin e klientëve.

Gjykata po ashtu vlerësoi pretendimet e paditësit se i padituri nuk është autoritet mbikëqyrës i zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, por gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 20 par.1 lidhur me par.4 dhe 5 i Ligjit nr. 05/L-096 i cili përcakton se: *“1. Subjektet raportuese mbajnë të gjitha të dhënat për informatat e mbledhura në pajtim me këtë ligj dhe sigurojnë se dokumentacioni dhe informacionet përcjellëse të jenë të gatshme dhe në dispozicion të NjIF-K-së, si dhe autoriteteve të tjera kompetente: ... 4. Subjektet raportuese sigurojnë masa të nevojshme për të mbrojtur të dhënat nga dëmtimi dhe për të parandaluar qasjen e paautorizuar. 5. Në pajtim me paragrafin 2. të nenit 66 të këtij ligji, NjIF-K, BQK ose një mbikëqyrës sektorial specifikojnë procedurat për mbajtjen e shënimeve në përputhje me këtë nen përfshirë ushtrimin e kontrolleve të brendshme për ruajtjen e të dhënave”,* autorizon NJIF që të mbikëqyrë ruajtjen e të dhënave personale për nevoja të raportimit nga obligimet që rrjedhin nga ky ligj, andaj i padituri me të drejtë ka konstatuar shkelje lidhur me moszbatimin e nenit 20 të Ligjit nr. 05/L-096.

Përfundimisht lidhur me shkeljen e nenit 21 të Ligjit nr. 05/L-096, gjykata vlerëson se par. 1 i këtij nenit përcakton obligimin që subjektet raportuese të emërojnë zyrtarin e pajtueshmërisë, ndërsa nga provat e administruara, gjykata ka konstatuar se paditësi ka emëruar zyrtarin e pajtueshmërisë vetëm pas realizimit të inspektimit të pajtueshmërisë, përkatësisht me datë 26.10.2018.

Andaj, nga provat e administruara, gjykata vlerëson se vendimi kontestues me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit kundër vendimit me të cilin paditësit i është shqiptuar gjoha

administrative në shumë prej 25,000.00€ (njëzet e pesëmijë euro) është i drejtë pasi që i padituri në procedurë administrative drejtë ka vlerësuar shkelje e paditësit lidhur me mos zbatimin e Ligjit nr. 05/L-096.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar pretendimet e paditësit lidhur me lartësinë e gjobës dhe faktin se paditësi nuk ka qenë në njohuri për obligimet ligjore që ka, por gjykata vlerëson se në përputhje me nenin 4 par. 3 dhe 4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *“3. Nëse ligji autorizon organin publik të ushtrojë pushtet diskrecionar në një vendimmarrje (në vijim “diskrecioni”), ai do të ushtrohet në mënyrë të ligjshme vetëm nëse plotësohen këto kushte: 3.1. nuk tejkalon kufijtë e përcaktuar në ligjin që lejon diskrecionin; 3.2. zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin për të cilin ligji e parashikon diskrecionin dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Ligji, në veçanti me parimin e proporcionalitetit, dhe 3.3. zgjedhja e organit publik nuk është në kundërshtim me normat e gjithëpranuara të shkencës apo teknikës dhe nuk shkel parimet themelore të drejtësisë apo arsyes njerëzore. 4. Pushteti diskrecionar, përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, është mundësia që i jepet një organi publik, shprehimisht apo që nënkuptohet me ligj, për të vendosur duke zgjedhur në mes dy apo më shumë veprimeve të ligjshme, për t’i shërbyer në mënyrën sa më të përshtatshme interesit publik.”*, NJIF gjatë përcaktimit të lartësisë së gjobës administrative ka vepruar në kuadër të diskrecionit që i ka përcaktuar ligji, duke mos tejkalluar kufijtë e përcaktuar me ligj dhe se një gjobë e tillë ka pasur për qëllim ti shërbej në mënyrë sa më të përshtatshme interesit publik, ndërsa lidhur me obligimet ligjore që paditësi ka pasur, në momentin e licencimit por edhe përmes emailit të datës 24.04.2014 i njëjti është njoftuar, përkatësisht ftuar që të marr pjesë në trajnim lidhur me obligimet që dalin nga ky ligj.

Prandaj, gjykata përfundimisht vlerëson se i padituri me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit në procedurë administrative, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat tjera materiale të cituara më lartë.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr. 97/22, datë 14.11.2022

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.